

RAPORT MONITORIMI

QASJA E TË RINJVE SHQIPTARË NË TEATËR



AUTOR
ILDA
KURTI

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Abstrakti

Ky raport rreket të shqyrtojë marrëdhënien që të rinjtë shqiptarë kanë në lidhje me teatrin. Gjetjet kryesore të këtij studimi bazohen në pyetësorin e zhvilluar online nga Qëndresa Qytetare. Shfaqjet teatrale, koncertet dhe shfaqjet operistike kanë qenë shumë të thukëta përgjatë kësaj periudhe. Pandemia detyroi kyçjen e aktiviteteve artistike nga frika e përhapjes së koronavirusit, dhe për pasojë, numri i vizitorëve të grupmoshave të reja ka përfunduar në zbritje drastike. Hulumtimi përpiqet të kuptojë nismat e ndërmarra nga institucionet qendrore në mbështetje të këtij sektori të artit, si dhe të identifikojë disa nga problemet kryesore të tij në lidhje me mungesën e hapësirave të dedikuara ndaj arteve performuese.

Fjalë çelës: *teatri, të rinjtë, anketë, kultura, hapësirat kulturore.*

Pasqyrë e lëndës

Abstrakti	2
1. Hyrje	4
Si ka funksionuar teatri për kontekstin shqiptar?	4
Problematikat e sektorit.....	5
2. Metodologjia e pyetësorit	7
Gjetjet kryesore	12
Rekomandime.....	13
Bibliografia.....	14

1. Hyrje

Gjurmët e teatrit në Shqipëri duket të jenë tepër të hershme, gjykuar nga numri i lartë i teatrove antikë të ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë. Butrinti, Amantia, Dyrrachiumi - janë disa nga gjurmët më të hershme që tregojnë për nivelin e lartë të zhvillimit dhe rëndësinë që i kushtohet hapësirave publike në funksion të arteve performuese.

Në teoritë e studimit të teatrit, një nga konceptet kyçe për studimin teorik të artit poetik teatral është koncepti i **katharsis**¹ [shqiptohet: katarzë], koncept ky i përmendur gjerësisht nga Aristoteli. Sipas [Fjalorit të Gjuhës Shqipe](#), fjala katarsis shpjegohet si “*paqëtim ose ulje emocionesh të forta; pastrim nga të këqijat*”². Sipas qasjes filozofike që Aristoteli i bën katarsisit, është një nga funksionet parësore të artit poetik, që nëpërmjet **mimesis**³ [kupto: imitimit] dhe **diegesis**⁴ [kupto: rrëfimit], arrin që të përçojë emocione të forta tek spektatori, duke bërë spastrimin nga emocionet negative nëpërmjet artit. Duke e përjetuar debatin tek jetët tona, dhe duke aplikuar korpusin e ngjarjeve që rrëfehen në skenë tek jetët tona, ne si shikues kemi tendencën që të “edukojmë ndjenjat tona” nga emocionet e këqija.

Për shkak të funksionit thellësisht edukues që luan arti në lidhje me edukimin, është parë e udhës që gjithmonë e më shumë të bëhet pjesë e kurrikulave mësimore edukimi dramatik. Sipas Aleancës Amerikane për Edukim Teatral [[American Alliance for Theatre Education](#)] ka një sërë përftimesh edukimi teatral qysh në moshë të hershme, duke e nisur nga impakti përmirësues i performancës akademike⁵, e deri tek pasojat shoqërore, ku nxënësit që braktisin shkollën ndihen më të motivuar për të qëndruar në klasë⁶. Megjithëse kurrikulat mësimore në Shqipëri kanë vite që kanë përfshirë edukimin dramatik në mësimdhënie, impakti i kësaj politike nuk ka qenë i matur deri më tash për kontekstin shqiptar.

¹ Aristotle. Poetics.

² ASHSH. “Fjalor i Gjuhës Shqipe”. 2006. Burimi: <https://fjalorthi.com/katarsis> (aksesuar më 10.05.2022).

³ Aristotle. Poetics.

⁴ Ibid.

⁵ AATE. “The Effects of Theatre Education”. [Efektet e Edukimit Teatral]. Burimi: <https://www.aate.com/benefits-of-theatre-ed> (aksesuar më 27.04.2022).

⁶ Ibid.

Si ka funksionuar teatri për kontekstin shqiptar?

Historia e zhvillimit të teatrit në Shqipëri është e hershme, por për arsye studimore do të fokusohemi fare pak tek periudha që pasoi periudhën e pasluftës së Dytë Botërore. Regjimi diktatorial që po instalohet, e përdori teatrin si një mjet më shumë në aradhën e mjeteve ideologjike, duke aplikuar masivisht pikëpamjet estetike ideologjike të realizmit socialist. Kështu, në grupin e mjeteve propagandistike, u pagëzua edhe ***“Teatri Popullor”***, ai që sot do të përkonte me ish-godinën e shembur të Teatrit Kombëtar.

Pavarësisht pengesave ideologjike, prej aty doli një plejadë e shquar aktorësh e dramaturgësh shqiptarë. Megjithëse dikur teatri u bë një mjet më shumë i përcimit të diktaturës së proletariatit, sot teatri shërben si një hapësirë bisedimi për shprehjen e lirisë artistike. Përkundër për nga vetë koncepti i krijimit të tij, shfaqjet artistike në Shqipëri po kthehen gjithmonë e më shumë në “pasione elitiste”, ku pjesëmarrësit janë ose spektatorët e kultivuar, ose ata me mundësira më të larta ekonomike.

Përgjatë diktaturës së proletariatit, hapësirat fizike të teatrove shërbenin si “shtëpi kulture”, ku mbaheshin të gjithë sojet e ngjarjeve kulturore, apo atyre politike/ideologjike. Sot teatrot janë disi më të institucionalizuar, ama gjithsesi nuk e përmbushin dot tërësisht rolin edukativ. Skena artistike në përgjithësi është e tulatur nga izolimi i pandemisë, kosto ekonomike që do të vijojë të reflektohet gjatë në vend.

Problematikat e sektorit

Menaxhimi i sektorit kulturor has shumë probleme. Në analizën që Philippe Kern bëri në 2018 për skenën kulturore shqiptare, ai ngre çështjen e hapësirave që mungojnë, nevojën për restaurimin e institucioneve kulturore, mungesën e aktorëve profesionistë, dhe mbi të gjitha, mungesën e bashkëpunimeve artistike ndërmjet institucioneve kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar⁷.

⁷ Kern, Philip. “Një Strategji Kulturore për Shqipërinë. Mbijllja e çimkës kulturore.” [Titulli në origjinal: A Cultural Strategy for Albania. Implanting the Cultural Bug.]. Këshilli i Europës. Mars, 2018. Burimi: <https://rm.coe.int/a-cultural-strategy-for-albania-implanting-the-cultural-bug/1680794665> (aksesuar më 20.04.2022).

- Extreme reliance on State budget (with little funding) for main cultural institutions.
- Dramatic underfunding (the Ministry's budget and staffing is a third of the budget in Georgia for instance).
- Need for clear criteria and their application for subsidy allocation (e.g. relevance for social/cultural debates and emancipation; audience attention; international recognition; international touring; participation in collaborations, awards; regional co-operation; etc).
- Private consumption in culture is to be developed to attract the younger generation.
- Lack of performance indicators for cultural institutions.
- No flagship cultural event or festivals with international reputation.
- Lack of storage space at National Library, National Film Archive and National Theatre.
- Lack of professional actors (Theatre).
- Lack of training in cultural assets management (no Master Degree in cultural management in business schools or universities).
- Legal framework to incentivise sponsorship, patronage to be developed.

4.2.4 Culture and Creative industries

- Insufficient understanding of the contribution of cultural investment to economic development, job creation or to social cohesion.
- Insufficient dedicated support for local talents and creation (insufficient commissioning – as budget is very low (less than EUR 300 000 / year).
- Distribution infrastructure of cultural product is weak (exhibition, bookstores).
- Culture and creative industries are looking for an interlocutor at government level to help contribute to the modernization of numerous areas of public policy – education, social, entrepreneurship, urban planning.
- Insufficient understanding of the contribution of independent cultural centres, incubators, hubs to the cultural performance and of their potential to retain/attract talents and contribute to entrepreneurship.
- Lack of statistical information on size of the sector and its contribution to the economy and employment.
- Identify technical skills, facilities and training requirements to make Albania attractive to foreign investment in film, games, animation and music (as a low cost production country with a rich heritage and tradition)

Kern, Philip. "Një Strategji Kulturore për Shqipërinë. Mbjellja e çimkës kulturore." Burimi: [Faqja 12](#).

Një autokritikë e ngjashme zhvillohet dhe nga vetë Ministrja e Kulturës, zonja Margariti, në fjalën hapëse të saj, në lidhje me situatën. Ministria e Kulturës, në "[Strategjinë Kombëtare për Kulturën 2019-2025](#)" është zotuar në zhvillimin e "investimeve kapitale në fushën e artit [...] fokusuar kryesisht në rindërtimin e teatrove publike dhe krijimin e hapësirave në tërë vendin.⁸"

Investimet kapitale në fushën e artit janë fokusuar kryesisht në rindërtimin e teatrove publike dhe krijimin e hapësirave në tërë vendin. Dy qytetet më të rëndësishme kulturore Shkodra dhe Korça kanë përfituar nga rindërtimi i teatrove Migjeni dhe Çajupi, ndërsa në Tiranë është krijuar skena e re shumë funksionale "ArTurbina"¹¹, si hapësirë për shfrytëzim nga institucionet e varësisë dhe operatorët e pavarur kulturorë. Në vitin 2017 ka filluar rindërtimi i godinës së Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, ndërsa në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës ka filluar procesi për rikonceptimin dhe ndërtimin e godinës së Teatrit Kombëtar, në një nga objektet me infrastrukturë moderne të fushës, e denjë për rolin e saj në historinë dhe zhvillimin e teatrit në Shqipëri.

Në kuadër të fushës së artit, rëndësi e madhe iu dha përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë në aktivitete ndërkombëtare si Bialja e Artit dhe Bialja e Arkitekturës në Venecia, pjesëmarrjeve në panairt e librit në Lajpcig, Torino dhe aktivitete të tjera të rëndësishme ndërkombëtare.

"Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025", faqja 4. Burimi: [Ministria e Kulturës](#).

⁸ Ministria e Kulturës. "Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025". Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtarep%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf> Fq. 4.

2. Metodologjia e pyetësorit

Gjetjet e këtij raporti bazohen në një pyetësor të administruar nga Qëndresa Qytetare në formatin online. Pyetësori u administrua nëpërmjet Google Form dhe më pas u shpërnda hapur nëpërmjet reklamave në rrjetin social Facebook.

Sondazhi mblodhi 202 përgjigje, dhe të dhënat demografike të siguruara dominoheshin nga vajzat në 57.4%. Të anketuarit i përkisnin grupmoshës së re: 59.9% përbëheshin nga 15-22 vjeç, dhe 40.1% i përkisnin grupmoshës 23-30 vjeç. Për sa i përket arsimit të të anketuarve, dominohej në 43.1% nga personat me arsim të mesëm, 24.3% me arsim të nivelit Bachelor, 36.1% kishin nivelin master, dhe 1% në nivel doktorat.

Vendbanimi me përqëndrimin më të lartë të të anketuarve ishte i përqëndruar në Tiranë, i pasuar me Shkodrën, Vlorën, Durrësin dhe Elbasanin. Paçkah se anketimi mblodhi përgjigje të shpërndara pothuajse në të gjitha qytetet kryesore të vendit, dominanca e përgjigjeve nga të rinjtë e qyteteve të pajisura me teatro, kanë influencuar gjetjet e këtij raporti, duke kufizuar mundësitë e dhënies së një tabloje sa më të plotë dhe gjithpërfshirëse të realitetit të atyre të rinjve që rriten qyteteve pa teatro.

1. 43.6% e të anketuarve e kanë njohur teatrin pas moshës 15 vjeçare.

Kështu i janë përgjigjur pyetjes se sa vjeç kanë shkuar për herë të parë në teatër. 25.7% e tyre kanë shkuar për herë të parë në moshën 15-18 vjeç, 14.4% e tyre kanë vizituar teatrin për herë të parë në moshën 18-22 vjeç dhe 3.5% e tyre vetëm pas moshës 22-30 vjeç. Të dhënat e mbledhura nga kjo pyetje janë shqetësuese, pasi 17.9% prej tyre janë prezantuar për herë të parë me teatrin në moshë të rritur, pas të tetëmbëdhjetave.

Një interpretim i këtyre të dhënave mund të ishte pasi përgjatë periudhës së studimeve universitare, studentët zhvendosen në qytete universitare, të cilat janë të pajisura me teatro dhe u mundësojnë qasjen në jetën kulturore.

Prapeseprapë, **këto të dhëna dëshmojnë se qasja drejt arteve performuese nuk është kulturë e kultivuar që në vegjëli.** Përgjegjësia rëndon tek prindërit dhe tek institucionet arsimore, të cilët nuk kanë përmbushur rolin më minimal të prezantimit të 88 të rinjve në këtë rast me teatrin si një mjet edukues. Ne gjykojmë se përmasat reale të këtij kampioni mund të jenë shumë më të rënda nëse do të aplikoheshin në të gjithë njësitë administrative të Republikës së Shqipërisë (me përmasa më të mëdha të anketimit); duke na vërtetuar se **procesi i prezantimit me teatrin si godinë dhe mandej me artin dramatik, është i vonuar dhe i pajustificueshëm.**

- 2. Teatri është jashtë qytetit për 34.6% të të anketuarve.** Konkretisht, 25.2% e të anketuarve tregojnë se teatri më i afërt me vendbanimin e tyre është 1 orë larg, ndërsa për 9.4% të tyre teatri më i afërt është 2 orë larg nga shtëpitë e tyre. Pra, +34.6% e të rinjve shqiptarë e kanë teatrin fizikisht të paaksesueshëm.

Pamundësitë e të paturit një teatër pranë vendbanimit të tyre, bëjnë që shumë të rinj të privohen nga qasja në teatër. Sidomos për të rinjtë që vijnë nga familje me të ardhura ekonomike minimale. **Varfëria dhe mungesat logjistike bëjnë që këta të rinj të mos prezantohen nga afër me magjinë e teatrit, duke e bërë atë një aktivitet të aksesueshëm vetëm nga elita dhe familjet me të ardhura ekonomike mbi mesataren.**

8.9% e të anketuarve janë përgjigjur se kostoja e biletës së teatrit për ta është e papërballueshme. Nëse do të bënim një përlllogaritje të të ardhurave që i duhen një studenti në pragun e minimumit jetik, do të kuptonim realisht se qasja e studentëve në situata ekonomike të pafavorshme, në aktivitetet kulturore të qytetit të tyre mbeten thellësisht elitiste dhe jomikpritëse për më të varfrit.

3. **Hera e fundit në teatër për gjysmën e të anketuarve ka qenë përpara një viti. Konkretisht, 101 prej tyre nuk kanë qenë spektatorë të një shfaqjeje prej më shumë se një viti (minimalisht).** Kjo është një shifër alarmuese, por nëse përpiqemi të kërkojmë për arsytet se përse kaq shumë të rinj nuk kanë qenë spektatorë në shfaqjet artistike do të na duhej të listonim si arsye kryesore pandeminë e shkaktuar nga koronavirusi.

Për të kuptuar nëse kjo arsye do të ishte e vlefshme, Qëndresa Qytetare dërgoi një kërkesë për informacion pranë Ministrisë së Kulturës, ku kërkuam të vihemi në dijeni për numrin e shfaqjeve që ishin vendosur në skenë përgjatë vitit 2021 dhe vitit të tanishëm. Mandej, kërkuam të dimë se sa shfaqje ishin shfaqur online vjet dhe sivjet.

Fillimisht kjo kërkesë nuk mori asnjë përgjigje. Ishte vetëm pas ankesës së Qëndresës Qytetare pranë zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit që morëm një përgjigje më datën 05.05.2022.

Përmbledhje Statistikore		
Teatri Kombëtar		
Treguesi	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Mars 2022
Shfaqjet në total	60	25
Shfaqje fizike	26	19
Shfaqjet Online	34	6
Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli"		
Treguesi	Janar-Dhjetor 2021	Janar-Mars 2022
Shfaqjet në total	157	85
Shfaqje fizike	157	85
Shfaqjet Online	0	0

Përmbledhje Statistikore. Burimi: Ministria e Kulturës. Datë: 05.05.2022.

Shifrat e paraqitura në këtë përmbledhje statistikore tregojnë për një aktivitet të mpakur nga institucionet. Teatri Kombëtar ka mbajtur gjithësej 60 shfaqje në total përgjatë periudhës janar deri në dhjetor 2021. Nëse do të përlllogarisnim frekuencën e këtyre shfaqjeve, do të kuptonim se ky institucion ka dhënë shfaqje një herë në gjashtë ditë të vitit.

Rendimenti i ulët mundet lehtësisht t'i atribuohet pandemisë, po nëse do shihnim pak më thellësisht, institucioni nuk ka përdorur teknologjinë në favorin e vet, për të mundësuar qasjen e shikuesve nëpërmjet metodave virtuale. Sidomos në rastin e Shqipërisë, ku infrastruktura e teatrove mbetet e papërfillshme, lind nevoja që të mundësohen metoda kontemporane të pjesëmarrjes së publikut në teatër. Veçanësisht, kur bëhet fjalë për për zonat e paprivileguara, ku për nga ana logjistike qasja në teatro është e pamundur fizikisht.

E njëjta gjë vlen edhe për Teatrin Kombëtar Eksperimental "Kujtim Sphaivogli". Përgjatë vitit 2021 ky institucion nuk ka të regjistruar asnjë shfaqje të dhënë online. Krahasuar me Teatrin Kombëtar, rendimenti i punës është më intensiv dhe kanë mbajtur gjithësej 157 shfaqje. Pak a shumë një shfaqje një herë në dy a tri ditë.

Sipas të dhënave të INSTAT për pjesëmarrjen në kulturë përgjatë vitit 2019 dhe vitit 2020, mund të shohim se aktiviteti i këtyre 2 teatrove ka rënë ndjeshëm, nëse bëjmë krahasimin e 'erës së para-pandemisë' dhe asaj përgjatë pandemisë⁹.

⁹ INSTAT. "Statistika të Kulturës, 2020". Burimi: <http://www.instat.gov.al/media/8573/statistika-te-kultures-2020.pdf> (aksesuar më 05.05.2022).

Pjesëmarrja në Kulturë

Pjesëmarrja në aktivitete kulturore ka një ndikim të konsiderueshëm në mirëqënien e individit. Ky seksion paraqet të dhëna nga Ministria e Kulturës lidhur me numrin e aktiviteteve të organizuara në institucionet qendrore të artit si dhe pjesëmarrjen për secilin institucion.

Gjatë vitit 2020, janë organizuar gjithsej 328 shfaqje dhe premiera në institucionet qendrore të artit. Krahasuar me vitin e kaluar, ky tregues ka rënë ndjeshëm, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia. Megjithatë, institucionet e artit kanë vijuar veprimtarinë me shfaqje dhe premiera online, të publikuara në rrjete sociale. Në institucionet qendrore të artit, gjatë vitit 2020, morën pjesë në aktivitetet kulturore 38.332 spektatorë.

Tab. 1 Numri i shfaqjeve/premierave dhe spektatorëve në institucionet kulturore

Institucione të Artit	Shfaqje/premiera		Spektatorë	
	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2019	Viti 2020
Teatri Kombëtar Popullor	157	63	34.790	5.252
Teatri Kombëtar Eksperimental	444	135	64.684	16.044
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	161	45	70.647	7.476
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	236	65	31.795	6.274
Cirku Kombëtar	126	20	21.698	3.286
Gjithsej	1.124	328	223.614	38.332

Statistika të Kulturës, 2020. Burimi: [INSTAT](#).

Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2022 paraqiten goxha më intensive, ku Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" kryeson, duke dhënë 85 shfaqje.

Përtej anës sasiore, mendoj se është me vend të ngremë pyetjen se sa të përshtatshme janë programet artistike të këtyre institucioneve me grupmoshat e adoleshentëve? A janë këto shfaqje tërheqëse mjaftueshëm për botëkuptimin e një adoleshenti? Mungesa e prezencës së grupmoshave të reja në teatër mund të vijë nga një varg arsyesh të shtresëzuara njëra mbas tjetrës, por mendoj se do të ishte gjithmonë e udhës që të merrnim në konsideratë zhvillimin e politikave që i afrojnë të rinjtë tek teatri, duke dizenuar programe specifike për grupmoshat e gjimnazistëve, që t'i afrojnë medoemos nëpër teatro.

Gjetjet kryesore

Sipas sondazhit të zhvilluar nga Qëndresa Qytetare, 43.6% e të rinjve të anketuarve kanë shkuar për herë të parë në teatër pas moshës 15 vjeçare. Qasja e të rinjve drejt shfaqjeve artistike nuk vjen si një kulturë e kultivuar qysh nga vegjëlja.

3.5% e të anketuarve kanë shkuar për herë të parë në teatër në moshë të rritur, pas moshës 22-30 vjeçare. Prezantimi me artet performuese është tepër i vonë dhe i pajustificueshëm.

34.6% e të anketuarve e kanë teatrin më të afërt 1-2 orë larg nga banesat e tyre. 9.4% e tyre e kanë teatrin më të afërt dy orë larg nga vendbanimi i tyre.

Varfëria dhe mungesat logjistike bëjnë që këta të rinj të mos prezantohen nga afër me magjinë e teatrit, duke e bërë atë një aktivitet të aksesueshëm vetëm nga elita dhe familjet me të ardhura ekonomike mbi mesataren.

8.9% e të anketuarve u shprehën se kostoja e biletës së teatrit për ta është e papërballueshme ekonomikisht.

Hera e fundit në teatër për gjysmën e të anketuarve (101 prej tyre) ka qenë përpara një viti.

Rekomandime

Të krijohen politika të veçanta për të rritur nivelin e pjesëmarrjes së të rinjve në hapësirat kulturore. Të rishikohet politika e kartave të studentit dhe të sigurohet pjesëmarrja falas e studentëve nëpër shfaqjet artistike nëpërmjet kartës identifikuese të studentit. Për personat mbi 26 vjeç, mund të vendosen tarifa simbolike për pjesëmarrjen nëpër shfaqjet kulturore.

Të krijohen mundësitë logjistike për qasjen në teatër të të gjitha grupmohave anë e kënd Shqipërisë. Sistemi i mirë i organizimit mund të krijohet nëpërmjet zhvillimit të turneve të trupave lëvizëse artistike, brenda dhe jashtë vendit.

Mungesa e hapësirave fizike nuk duhet të jetë demoralizuese për artistët. Teatri mundëson zhvillimin e tij në të gjitha format dhe përshtatjen me të gjitha hapësirat. Bashkëpunimi i trupave artistike për improvizimin e shfaqjeve në natyrë të hapur do të mundësonte shanset për qasjen masive të popullatës në këtë zhanër artistik, duke kontribuar në rritjen e vetëdijes kolektive nëpërmjet katharsis-it.

Ministria e Kulturës duhet të mundësojë urgjentisht planin e punës për zgjidhjen e ngërçit të hapësirave skenike. Artistët skenikë meritojnë të punojnë në ambiente të dijnitetshme.

Të shfrytëzohet teknologjia në të mirë të informimit dhe edukimit të masave, duke krijuar një program të veçantë për punën online të teatrove shtetërore.

Bibliografia

AATE. "The Effects of Theatre Education". [Efektet e Edukimit Teatral]. Burimi: <https://www.aate.com/benefits-of-theatre-ed> (aksesuar më 27.04.2022).

Anketë e organizuar nga Qëndresa Qytetare.

Aristotle. Poetics. [Aristoteli. Poetika.]

ASHSH. "Fjalor i Gjuhës Shqipe". 2006. Burimi: <https://fjalorthi.com/katarsis> (aksesuar më 10.05.2022).

INSTAT. "Statistika të Kulturës, 2020". Burimi: <http://www.instat.gov.al/media/8573/statistika-te-kultures-2020.pdf> (aksesuar më 05.05.2022).

Kern, Philip. "Një Strategji Kulturore për Shqipërinë. Mbjellja e çimkës kulturore." [Titulli në origjinal: A Cultural Strategy for Albania. Implanting the Cultural Bug.]. Këshilli i Europës. Mars, 2018. Burimi: <https://rm.coe.int/a-cultural-strategy-for-albania-implanting-the-cultural-bug/1680794665> (aksesuar më 20.04.2022).

Ministria e Kulturës. "Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025". Burimi: <https://kultura.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/finale-Strategjia-Komb%C3%ABtarep%C3%ABr-Kultur%C3%ABn-2019-2025.pdf> Fq. 4.

Përgjigje zyrtare e kërkesës për informacion nga Ministria e Kulturës. Datë: 05.05.2022.

TEATRI
KOBETAR

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

